

Rregulla XII – Rruajtja e llogarive dhe e regjistrave të transaksioneve për banka dhe institucione financiare, e autorizuar me nenin 32 të Rregullores

(a) Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i krijojnë dhe t'i ruajnë në mënyrë të pastërt e të qartë shënimet e të gjitha llogarive të tyre dhe të gjitha transaksioneve që cilat i ekzekutojnë për llogaritë e tyre dhe për llogaritë e klientëve.

(b) Bankat dhe institucionet financiare i mbajnë shënimet në pajtim me nënparagrafin (a), të cilat dëshmojnë për të gjitha transaksionet brenda një periudhë kohore prej së paku pesë vitesh, duke filluar nga data kur janë kryer të gjitha veprimet tregtare për transaksionin për të cilin bëhet fjalë.

(c) “Shënimet” e një llogarie apo transaksioni përfshijnë veçmas kreditimet dhe debitimet, çeqet, raportet dhe korrespondencat të cilat reflektojnë apo ndihmojnë në kuptimin e kushteve dhe marrëveshjeve të rrethanave të cilat e rrethojnë veprimin e asaj llogarie apo kryerjen e atij transaksioni.

(ç) Shënimet elektronike të bankave dhe institucioneve financiare ruhen në formë elektronike dhe duhet të jenë në gatshme për ekzaminuesit e BPK-së në një formë të qartë, por ato duhet të jenë të gatshme për revizorët, autoritetet kompetente apo për persona e tjerë të autorizuar.

(d) Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka miratuar Rregullën XII më 17 shkurt 2000.